



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI"
KORÇË

Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
Web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al

Miratohet

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane
Programi i Studimit të Ciklit të Parë:
Bachelor në
"TEKNOLOGJI INFORMACIONI"

ME KOHË TË PLOTË
Viti akademik 2014-2015

Përgjegjësi i departamentit të Informatikë – Fizikës.

Dr. Rafail Prodani

DEKANI

Prof. Dr. Gjergji Pendavinji

Korçë 2014

1. Emërtimi i përgjithshëm i programit të ciklit të parë (bachelor) – me kohë të plotë.

Bachelor në “Teknologji Informatikë”

2. Vendimet e organeve përgjegjëse për hapjen e programit të studimit

Vendimi i Këshillit të Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane (FSHNH).	
Vendimi i Senatit akademik të Universitetit “Fan S. Noli” te Korçës (UNKO).	
Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit	Vendim Nr 518, datë 30.06.2010

NIVELI I PROGRAMIT TE STUDIMIT	SASIA E KREDITEVE
BACHELOR	180 kredite
Fillon më :	Tetor 2014
Përfundon më :	Korrik 2017

PROGRAMI I STUDIMIT I BRENDSHËM APO I JASHTËM PËR INSTITUCIONIN	
<input checked="" type="checkbox"/>	Bachelor i brendshëm (organizuar nga institucioni)
<input type="checkbox"/>	Bachelor i jashtëm (organizuar nga një institucion tjetër)

STRUKTURA PROPOZUESE DHE STRUKTURAT E TJERA	
Fakulteti apo një strukturë tjetër didaktike	FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE HUMANE DEPARTAMENTI I INFORMATIKËS - FIZIKËS
Struktura të tjera bashkëpunuese	MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS, DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE, KORÇË INSTITUCIONE TE TJERA PUBLIKE DHE PRIVATE
Institucione të huaja të arsimit të lartë ose Qendra të huaja kërkimore	

GJUHA E ZHVILLIMIT TË PROGRAMIT BACHELOR	
<input checked="" type="checkbox"/> Shqip	Shqip
<input type="checkbox"/> Në gjuhën	

3 Objektivat formuese të programit të studimit

Plani mësimor i Programit të Studimit “Teknologji informacioni” është bazuar në standardet e MASH dhe Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të lartë për organizimin e studimeve të ciklit të parë. Fushat specifike në programin e teknologjisë së informacionit janë: rrjetat kompjuterike dhe telematike, bazat e të dhënave, elektroteknikë, web-programimi, telekomunikacion, zhvillimi i aplikacioneve, që kanë potencial të madh për përgatitjen e specialistëve të rinj në tenologjinë e informacionit.

Kjo duket si në numrin e mjaftueshëm të disiplinave, që përmban rregullorja mësimore ashtu edhe në raportin midis grupdisiplinave të kësaj rregulloreje.

Organizimi i mësimimit është përpiluar që t’i përmbushë kërkesat e tregut lokal, por njëkohësisht edhe të mundësojë perspektivë moderne dhe globale specialistëve të rinj.

Objektivat kryesore të programit të studimit janë:

- T’u mundësojë studentëve që të fitojnë njohuri teorike dhe praktike për teknologjinë e informacionit dhe këto njohuri t’i aplikojë në jetën reale.
- Të diplomuarit do të fitojnë aftësinë për të fushat kryesore te TIK sic mund të jenë bazat e programimit, teknologjitë kryesore të internetit, rrjetat kompjuterike, bazat e elektronikës.
- Të diplomuarit do të jenë të aftë të implementojnë teknologjitë e reja të internetit dhe rrjeteve në ndihmë të rritjes së efikasitetit dhe transparencës së shërbimeve të ndryshme.
- T’i aftësojë studentët që të marin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve të ndryshme telematike.
- T’i aftësojë studentët që të marin pjesë në zhvillimin dhe implementimin e programeve te ndryshme aplikative ne ndihme te zgjidhjes se problemeve.
- T’i aftësojë studentët që të punojnë në projekte individuale dhe grupore, të cilat sipas natyrës mund të jenë: projekte shkencore-hulumtuese, projekte zhvillimore ose punë praktike.

Ky program studimi synon:

- Njohjen e sistemeve të komunikimit dhe teknologjisë informatike, si shkathtësi për shfrytëzimin e tyre në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Njohja, analiza e gjuheve programuese të ndryshme dhe algoritmeve dhe përdorimin e tyre në zgjidhjen e problemeve.
- Ballafaqimi me të dhënat, organizimin dhe përpunimin e të dhënave.

- Shkathtësi të përgjithshme dhe komunikative, si dhe njohja e gjuhës angleze në nivel relativisht më të lartë

Pas përfundimit të suksesshëm të programit studentët mund:

- T'i shfrytëzojnë sistemet operative të teknologjisë së informacionit në përditshmëri dhe më gjërë.
- Në mënyrë efektive t'i zbatojnë gjuhët programuese e studiuara dhe algoritmet.
- Të mundësojnë zgjidhje për probleme të ndryshme.
- Të organizojnë baza të dhënash, t'i projektojnë, implementojnë dhe më tutje ti mirëmbajnë dhe rregullojnë performansat e tyre.
- Të projektojnë dhe implementojnë rrjetat kompjuterike.
- Në mënyrë efikase të shfrytëzojnë sistemet dhe teknologjinë informatike.
- Të implementojnë dhe administrojnë faqe web statike dhe dinamike, si dhe të jenë në gjendje të implementojnë shërbime në ndryshme në web.
- Të organizojnë dhe të ndihmojnë zgjidhjet teknike duke e pershtatur atë me zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe tekniko -shkencore.

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të aftësohen:

- Që të shfrytëzojnë teknologjinë informatike dhe të ndihmojnë të tjerët gjatë shfrytëzimit të të njëjtës.
- Të ndihmojnë në përpunimin, krijimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve aplikative dhe në web për probleme të ndryshme.
- Të planifikojë dhe implementojë bazat e të dhënave.
- Të planifikojë dhe realizojë rrjetat kompjuterike.

Në përfundim të këtij programi studimi, studenti merr formimin bazë metodologjik, shkencor dhe praktik në disiplinat që përmban kurrikula e këtij programi studimi. Pas marrjes së diplomës hidhet hapi i parë drejt formimit të specialistëve të teknologjisë së informacionit, vecanërisht administratorëve të sistemit, administratorëve të rrjetave kompjuterikë, të databazave, programuesve, zhvilluesve të faqeve të webit.

Marrja e diplomës Bachelor në “Teknologji Informacioni” i jep mundësi studentit për të vazhduar studimet e ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master Shkencor”. Gjithashtu u jep mundësinë për të punuar si specialist i teknologjisë së informacionit në institucione dhe ndërmarje të ndryshme private dhe shtetërore. Vecanërisht si administratorë sistemi, mirëmbajtës dhe ekspert mbështetës i rrjetave kompjuterike, databazave, zhvillues programesh, dizenjues web-i.

3. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat e tjera bashkëpunuese

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	Departamenti Informatikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.
---	--

Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	Ministra e Arsimit dhe Sportit. Drejtoria Arsimore Rajonale, Korçe. Fakulteti i Ekonomik, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Departamenti i Matematikës, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë. Fakulteti Ekonomik dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Univesiteti i Tiranës.
Institucione të huaja të arsimit të lartë	
Subjektë të tjera publike apo private	Subjekte private dhe publike që veprojnë në qarkun e Korçës, Shqipëri.

4. Kuadri i përgjithshëm formues i programit të studimit

Në tabelën 1 paraqiten kreditet e nevojshme për cdo fushë disiplinore sipas tipeve të veprimtarisë.

Tabela 1. Kreditet për cdo fushë disiplinore(modul) sipas tipit të veprimtarisë

Tipi i veprimtarisë	Fushat disiplinore	Kredite	Gjithsej
Disiplina A	Analize Matematike 1	7	45
	Analize Matematike 2	6	
	Algeber	3	
	Gjeometri	3	
	Matematike Diskrete	5	
	Probabilitet dhe Statistike	6	
	Fizike e përgjithshme 1 (Mekanika)	5	
	Fizike e përgjithshme 2 (Termodinamika)	5	
	TFNK	5	
Disiplina B	Hyrje ne informatike	5	89
	Bazat e Programimit	5	
	Algoritmika dhe teknika programimi	5	
	Programim i orientuar mbi objekte	5	
	Telekomunikacioni	5	
	Bazat e elektronikës	5	
	Sisteme shfrytëzimi	5	
	Rrjeta kompjuterike	5	
	Web Design	5	
	Programim ne Web	5	
	Baza te dhenash	5	
	Sisteme administrimit e bazave te te dhenave	5	
	Arkitekture kompjuteri	5	
	Elektronike Lineare	5	
	Teori sinjalesh	5	
	Fibrat Optike	3	
	Programim ne Java	5	
	Multimedia	6	
Disiplina C	Kimi e përgjithshme	5	16
	Fizike e Përgjithshme 3 (Elektriciteti, Magnetizmi, Optika)	6	
	Elektroteknike	5	

		2	
Disiplina D	Kriptografi, Gjuhe e huaj(Anglisht2)	2	8
	MathLab, Gjuhe e huaj e dyte	2	
	Spss, Simulim Numerik	2	
	Llogjike, Radiometri	2	
Disiplina E	Gjuhe e huaj	5	15
	Manaxhimi i projekteve	5	
	Manaxhimi I sistemeve te informacionit	5	
Disiplina F	Mbrojtje diplome	7	7
			180

Për të realizuar programin e studimit janë parashikuar si veprimtari formuese *leksione, seminare, projekte/ detyra kursi, kolokiume.*

5. Personeli akademik për realizimin e programit

Për realizimin e programit të studimit të Bachelor në “Teknologji Informacioni” do të angazhohet efektiviteti i departamentit të Informatikës dhe Fizikës, pedagogë nga departamente të tjerë të fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, pedagogë nga Fakulteti i Ekonomik, Universiteti i Korçës, nga fakulteti Ekonomik të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës si dhe nga firma private kompjuterike. Në tabelën 2 paraqitet një listë e pedagogëve të parashikuar në procesin e mësimdhënies.

Tabela 2. Lista e pedagogëve të parashikuar për mësimdhënie

Personeli akademik (me kohë të plotë ose të pjesshme)	Titulli apo grada shkencore	Institucioni	Departamenti	Spektori mësimor - kërkimor
Lorenc Ekonomi	Prof. As. Dr.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Matematikë
Mirela Cini	Prof. As. Dr.	F.E. UNKO	Menaxhimit	Menaxhim
Ilia Ninka	Prof. Dr.	F.SH.N. UT	Informatikës	Informatikë
Rafail Prodani	Dr.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Marinela Polena	Doc.	F.E. UNKO	Menaxhimit	Menaxhim
Gloria Tyxhari	Dr.	F.E. UT	M.S.I.Z.	Informatike
Magdalini Vampa	Dr.	F.SH.N.H. UNKO	Filozofi Sociologji	Filozofi
Thoma Lice	Dr.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Fizikë
Sulltana Ajce	Msc.	F.Bujqesisë UNKO	Biokimisë dhe Agroushqim	Kimi
Pavlo Cicko	Dr.	UNKO	Gjuheve te huaja.	Gjuha Franceze

Suela Pici	Dr.	UNKO	Gjuheve te huaja.	Gjuha Angleze
Gjergji Çapollari	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Matematikë
Lorena Margo	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Matematikë
Dhori Beta	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Blerina Çeliku	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Erma Pema	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Marsel Kotori	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Arto Adili	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Matematikë
Argjir Butka	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	Matematikës	Matematikë
Marijon Pano	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Informatikë
Lorena Kelo	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Fizikë
Sotiraq Marko	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Fizikë
Nereida Panolli	Msc.	F. Edukimit UNKO	Anglishes	Anglisht
Ilir Çapi	Msc.	F.SH.N.H. UNKO	I.F.	Fizikë

UT – Universiteti i Tiranës.

F.SH.N – Fakulteti i Shkenca të Natyrës.

F.E – Fakulteti Ekonomik.

UVL – Universiteti “ Ismail Qemali”, Vlorë.

U.P.T. – Universiteti Politeknik i Tiranës.

I. F. – Informatikë dhe Fizikë.

M.S.I.Z. – Matematikës së Zbatuar, Statistikës dhe Informatikës.

UNKO – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

F.SH.N.H - Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane.

7. Plani mësimor

Në tabelën 3 paraqitet plani mësimor i programit të studimit “Teknologji Informacioni” sipas disiplinave mësimore për çdo semestër.

Tabela 3. Plani mësimor i programit mësimor

Nr	Disiplina mesimore apo titulli i veprimtarisë	Tipi i disipl	Ndjekja e seminareve	Kredite	Leks.	Sem.	Lab	Lloji i provimit	Orë studimi individual
Viti I, Semestri I									
1	Analize Matematike 1	A	75%	7	45	45	-	Shkrim.	85
2	Algjeber	A	75%	3	15	15	-	Shkrim.	45
3	Gjeometri	A	75%	3	15	15	-	Shkrim.	45
4	Hyrje ne Informatike	B	75%	5	15	38	-	Gojë (Komp).	72
5	Matematika Diskrete	A	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
6	Fizike e Pergjithshme 1 (Mekanika)	A	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
Gjithsej semestri I				28	150	173			377
Viti I, Semestri II									
7	Analize Matematike 2	A	75%	6	30	30	-	Shkrim.	90
8	Probabilitet dhe Statistike	A	75%	6	30	30	-	Shkrim.	90
9	Kimi e Pergjitheshme	C	75%	5	30	23	-	Shkrim.	72
10	Bazat e Programimit	B	75%	5	15	38	-	Shkrim.	72
11	Fizike e Pergjitheshme 2 (Termodinamika)	A	75%	5	30	30	-	Shkrim dhe gojë.	65
12	Gjuhe e Huaj, Anglisht.	E	75%	5	40	20	-	Shkrim.	65
Gjithsej semestri II				32	175	171			454
Gjithesej viti i pare				60	325	344			831
Viti II Semestri III									
1	TFNK	A	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
2	Fizike e Pergjitheshme 3 (Elektriciteti, Magnetizmi)	C	75%	6	45	30	-	Shkrim.	75
3	Algoritmika dhe teknika programimi	B	75%	5	15	45	-	Shkrim.	65
4	Bazat e elektronikes	B	75%	5	30	23	-	Shkrim.	72
5	Manaxhimi i projekteve	E	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
6	Sisteme shfrytezimi	B	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
7	Lende me zgjedhje ¹	D	75%	2	15	15	-	Shkrim.	20
				0	0	0			0
Gjithsej semestri III				33	195	203	-		427
Viti II Semestri IV									
8	Eletroteknike	C	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
9	Programim i orientuar mbi objekte	B	75%	5	23	30	-	Shkrim.	72
10	Telekomunikacion	B	75%	5	30	23	-	Shkrim.	72
11	Manaxhimi I sistemeve te informacionit	E	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
12	Rrjeta kompjuterike	B	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65

13	Lende me zgjedhje ²	D	75%	2	15	15	-	Shkrim.	20
	Gjithsej semestri IV			27	158	158	-		359
	Gjithsej viti II			60	353	361	-		786
	Viti III, Semestri V								
1.	Web Design	B	75%	5	15	38	-	Gojë (Komp).	72
2.	Baza te dhenash	B	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
3.	Arkitekture kompjuteri	B	75%	5	30	30	-	Shkrim.	65
4.	Fibrat Optike	B	75%	3	15	15	-	Shkrim.	45
5.	Lende me zgjedhje ⁴	D	75%	2	15	15	-	Gojë (Komp).	20
6.	Programim ne Java	B	75%	5	23	30	-	Shkrim.	72
7.	Gjithsej semestri V			25	128	158	-		339
8.									
9.	Viti III, Semestri VI								
10.	Sisteme administrimit e bazave te dhenave	B	75%	5	23	30	-	Shkrim.	72
11.	Elektronike Lineare	B	75%	5	23	30	-	Shkrim.	72
12.	Teori sinjalesh	B	75%	5	30	23	-	Shkrim.	72
13.	Multimedia	B	75%	6	30	30	-	Shkrim.	90
14.	Programim ne Web	B	75%	5	23	30	-	Shkrim.	72
15.	Lende me zgjedhje ³	D	75%	2	15	15	-	Shkrim.	20
16.	Gjithsej semestri VI			28	144	158		Shkrim.	398
17.	Teza e Diplomes	F		7	90	-	-		85
18.	Gjithsej viti III			60	362	316	-		822
								Gjith.	2439
	Gjithsej programi i studimit		Kredite	180	Orë Lek/Sem ...	2061	Tota l orë		4500

¹ Lëndë me zgjedhje:

1. Gjuhe e huaj e dyte (Frengjisht)
2. Kriptografi

2 Lëndë me zgjedhje:

3. Gjuhe e huaj (Anglisht)
4. MathLab

³ Lëndë me zgjedhje:

5. SPSS
6. Simulim Numerik

⁴ Lëndë me zgjedhje:

7. Llogjikë
8. Radiometri

Ne tabelen 4, paraqiten lëndet dhe modulet e programit të studimit:

Tabela 4, lëndet dhe modulet e programit të studimit, viti akademik 2014 – 2015.

Viti I				
Nr.	Lenda (Veprimtaria Formuese)	Ore gjithsej	Kredite	Semestri, Pedagogu, Lek/Sem.
	a) Moduli 1 b) Moduli 2			
1	Analiza matematike(A)	150	13	
	<i>a: Analize matematike 1</i>	90	7	Zhvillohet simestrin e pare, L. Margo, 3/3
	<i>b: Analize matematike 2</i>	60	6	Zhvillohet simestrin e dyte, L. Margo, 2/2.
2	Algjeber, Gjeometri (A)	60	6	
	<i>a: Algjeber Gjeometri</i>	30 +30	6	Zhvillohet simestrin e pare A.Butka 2/2
3	Matematike (A)	120	11	
	<i>a: Matematike diskrete</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e pare , A.Adili, 2/2
	<i>b: Probabilitet dhe statistike</i>	60	6	Zhvillohet simestrin e dyte, L. Ekonomi, 2/2
4	Informatike (B)	106	10	
	<i>a: Hyrje ne informatike</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e pare, Dh. Beta, E. Guliqani 1/2.5
	<i>b: Bazat e Programimit</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, Dh. Beta, 1.5/2.5 E. Mancellari
5	Fizike e pergjithshme (A)	120	10	
	<i>a: Fizike e pergjithshme 1 (Mekanika).</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e pare L. Kelo, 2/2.
	<i>b: Fizike e pergjithshme 2 (Termodinamika).</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e dyte, Th. Lice, 2/2. E. Guliqani
6	Kimi e pergjithshme (C)	53	5	
	<i>a: Kimi e pergjithshme</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, 2/1.5 . S. Ajce
7	Gjuhe e huaj (E)	60	5	Zhvillohet gjate vitit me ngarkese 2 ore ne jave, 2/1. Msc. Nereida Panolli
	Gjithsej	669	60	
Viti II				
Nr.	Lenda	Ore gjithsej	Kredite	Pedagogu
1	TFNK (A)	60	5	

	<i>a: TFNK</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e dyte, Gj. Capollari, 2/2.
2	Elektroteknike (C)	135	11	
	<i>a: Fizike e Pergjithshme 3 (Elektriciteti, Magnetizmi, Optika)</i>	75	6	Zhvillohet simestrin e pare, S. Marko, 3/2.
	<i>b: Elektroteknike</i>	60	5	I.Çapi Zhvillohet simestrin e dyte, M. Kotori 2/2
3	Programim i avancuar (B)	113	10	
	<i>a: Algoritmika dhe teknika programimi</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e pare, Dh. Beta1/3
	<i>b: Programim i orientuar mbi objekte</i>	53	5	E. Mancellari. Zhvillohet simestrin e dyte, B.Celiku, 1.5/2
4	Telekomunikacioni dhe bazat e elektronikes(B)	106	10	
	<i>a: Telekomunikacioni</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, E. Pema 2/1.5
	<i>b: Bazat e elektronikes</i>	53	5	S.Dojçe. Zhvillohet simestrin e pare, M. Kotori, 2/1.5
5	Manaxhimi I sistemeve te informacionit dhe I prtojekteve (E)	120	10	
	<i>a: Manaxhimi i projekteve</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e pare, M. Cini 2/2
	<i>b:Manaxhimi I sistemeve te informacionit</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e dyte, M. Polena 2/2
6	Sisteme shfrytezimi dhe rrjeta kompjuterike (B)	120	10	
	<i>a: Sisteme shfrytezimi</i>	60	5	M. Pano,Zhvillohet simestri i pare, 2/2
	<i>b: Rrjeta kompjuterike</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e dyte. E. Pema, 2/2
7	Lende me zgjedhje (D)	60	4	
	<i>a: Gjuhe e huaj e dyte, Kriptografi</i>	30	2	B.Celiku
	<i>b: Gjuhe e huaj, MathLab,</i>	30	2	Zhvillohetsimestrin e pare, 1/1 Zhvillohetsimestri i dyte 1/1, A. Butka
	Gjithsej	714	60	
Viti III				
Nr.				
1	Web Technologies (B)	106	10	
	<i>a: Web Design</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e pare, R. Prodani, 1.5/2
	<i>b:Programim ne Web</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, R. Prodani, 1.5/2
2	Baza te dhenash dhe administrimi i tyre (B)	113	10	

	<i>a: Baza te dhenash</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e pare, B.Celiku, 2/2
	<i>b: Sisteme administrimit e bazave te te dhenave</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, Dh. Beta, 1.5/2
3	Aplikime Elektronike (B)	113	10	
	<i>a: Arkitekture kompjuteri</i>	60	5	Zhvillohet simestrin e pare, E. Pema2/2
	<i>b: Elektronike Lineare</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, M. Kotori, 1.5/2
4	Perpunim INFORMACIONI (B)	83	8	
	<i>a: Teori sinjalesh</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e dyte, M. Kotori, 2/1.5
	<i>b:Fibrat Optike</i>	30	3	Zhvillohet simestrin e pare, E. Pema, 1/1.
5	Programim & Multimedia (B)	113	11	
	<i>a: Programim ne Java</i>	53	5	Zhvillohet simestrin e pare, B.Celiku, 1.5/2.
	<i>b: Multimedia</i>	60	6	Zhvillohet simestrin e dyte, 2/2, G. Tuxhari,.
6	Lende me zgjedhje (D)	60	4	
	<i>A: Spss, Simulim Numerik.</i>	30	2	Zhvillohet simestrin e dyte, 1/1, L. Margo
	<i>B: Llogjike, Radiometri.</i>	30	2	Zhvillohet simestri i pare 2/0, M. Vampa.
7	Teza e diplomes (F)	90	7	
		678	60	

a) Kushtet e pranimit në këtë program studimi:

Në këtë program studimi pranimi i studentëve do të bëhet mbi bazën e kriterëve të maturës shtetërore, të përcaktuara nga MASH. Këta studentë duhet të kenë formimin e nevojshëm nga shkolla e mesme, për të ecur më pas në përvetësimin që përmban programi i ri i studimit.

8 Infrastruktura në dispozicion të programit

a. Auditorë

F.SH.N.H ka në dispozicion 1 auditor me kapacitet rreth 140 vende, 2 auditorë me kapacitet 80 vende 10 klasa për zhvillimin e orëve të seminareve me kapacitet 20- 40 vënde, dy laboratorë kompjuterat me 30 kompjutera secili, , internet broadband 24 orë në gjitha ambjentet e fakultetit. Universiteti i “Fan S. Noli” i Korçës ka marrë në pronësi edhe shtëpinë e oficerave, Korcë dhe rreth 10 klasa me kapacitet 30 vënde do të vihen në dispozicion të programeve Bachelor dhe Master.

b. Laboratorë

F.SH.N.H ka 2 laboratorë informatike me rreth 30 vende secili.

c. Biblioteka

F.SH.N.H ka 1 bibliotekë në dispozicion të të gjithë studentëve të fakultetit, e organizuar sipas një sistemi bashkëkohor kërkimi dhe studimi. Kjo bibliotekë garanton mbështetjen e programit të studimit me një informacion të përditësuar të nivelit të lartë.

9. Kriteret specifike të pranimit të studentëve në program

Numri i studentëve që do të pranohen në program	120
Numri minimal i studentëve për hapjen e programit	10

f) Mundësitë e transferimit të studentëve ndërmjet programeve të studimit të ciklit të parë

Studentët, të cilët ndjekin Programin e studimit të Bachelorit në “*Teknologji Informacioni*” mund të transferohen në një program tjetër të Ciklit I në Universitetin e Korçës ose në programe të tjera studimi të ngjashme në Universitete të tjera. Ndërkaq studentët të cilët ndjekin një Program tjetër studimi të Ciklit I të ngjashme me Programin Bachelor me kohë të plotë “*Teknologji Informacioni*” mund të transferohen në programin e studimit të Ciklit I në “*Teknologji Informacioni*” të Fakultetit të SH.N.H. Në lidhje me transferimin e dytë të përmendur, do të analizohet çdo rast në veçanti në përputhje me rregulloren e Universitetit. Ekuivalentimet e moduleve të ndryshme kryen nga komisionet e njohjes dhe ekuivalentimit ngritur nga departamentet përkatëse, me kërkesë të departamentit të Informatikës dhe Fizikës.

g) Modalitetet e përgatitjes, paraqitjes dhe vlerësimit të tezës së diplomës

Mbrojtja e Temës së Diplomës Bachelor bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim për studentët me mesatare të ponderuar të të tre viteve të studimit mbi ose baraz me 7.5. Ky punim presupozohet të përbëjë rezultatin e një kërkimi me origjinalitet shkencor, si nga pikëpamja e përzgjedhjes së argumentit ashtu edhe për nga metodologjia e kërkimit. Punimi i diplomës duhet të përmbajë rreth 25 faqe në format A4.

Për studentët e tjerë Mbrojtja e Temës së Diplomës Bachelor bëhet me provim me shkrim duke përfshirë pyetje nga të gjitha lëndët e formimit karakterizues të programit të studimit. Ky provim ju përmbahet të gjitha rregullave të provimit me shkrim dhe të vlerësimit të studentëve nga 0 në 100 pikë.

Tipologjitë e temave:

Temat e hartuara nga studentët diplomantë do të jenë në fushat e mëposhtme:

– *Internet Technologies*

- Zhvillimi i aplikimeve në biznes (business application development)
- Zhvillimi i portaleve dhe aplikimeve ne Internet (Internet Application Development)
- Rrjetat dhe komunikimi (Communication and Networking)
- Aplikime të Database management systems (DBMS applications)
- Elemente te teorive dhe zbatime te gjuheve te programimit.
- Projektimi i amplifikatoreve me shume stade dhe amplifikatoret operacionale.
- Perpunimi i sinjaleve dhe teknika transmetimesh dixhitale.
- Sistemet moderne te telekomunikacionit.

Tema e diplomës së Ciklit I zhvillohet nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Gjithashtu, tema e diplomes ka dhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin brenda semestrit të parë të Vitit të tretë, të cilët firmosin një formular. Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohen përfundimisht pranë Sekretarisë së Departamentit.

Studenti nuk lejohet të mbrojë diplomën, nëqoftëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit të fundit si dhe ato të mbartura.

Për t'u pranuar në provimin e mbrojtjes së temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, të ketë marrë 173 kredite të Ciklit I. Punimi dorëzohet një muaj përpara datës së mbrojtjes në tre kopje. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose/dhe nuk kanë marrë 173 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e verës. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar, gjithashtu, punimin një muaj përpara datës së mbrojtjes, studentëve u buron e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin përkatës e vitit akademik pasardhës.

Studenti i vitit të fundit, i cili në përfundim të provimeve të kursit, në sezonin e parë, rezulton me detyrime mësimore të pashlyera, ka të drejtë t'i shlyejë ato në sezonin e verës, para mbrojtjes së diplomës.

Komisioni dhe vlerësimi

Komisioni përbëhet nga 3-5 pedagogë të fushave përkatëse. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Departamentit. Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere: përmbajtja e punimit, mënyra e paraqitjes me gojë dhe mesatarja e tre viteve të studimeve.

k) Propozimi për tarifën e shkollimit, të argumentuar me koston

Programi i Studimit "BACHELOR" në Teknologji Informacioni financohet me tarifën e shkollimit të aplikantëve në këtë Program, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave.

RREGULLORE MËSIMORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR ME KOHE TE PLOTË NË FUSHËN “TEKNOLOGJI INFORMACIONI”

Hartimi i kësaj rregulloreje është bazuar në ligjin nr. 9741 dt.21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në udhëzimin nr. 14, dt. 03.04.2008 “Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në IPAL, si edhe në udhëzimin nr.15, dt. 04.04.2008 “ Për organizimin e studimeve në IPAL”.

1. PARATHËNIE

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të mbështesë organizimin e programeve të studimit duke orientuar drejt studentët në mbarëvajtjen e studimeve. Rregullorja specifikon aspektet organizative të programeve të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane.

Departamenti “Informatikës dhe Fizikës” ofron për studentët nje program studimi Bachelor me kohë të plotë.

2. PROGRAMET E STUDIMIT DHE TITUJT PËRKATËS

Program studimi i Ciklit I me lëshimin e diplomës:

Bachelor në “Teknologji Informacioni”

3. TRANSFERIMET NË KËTË PROGRAM STUDIMI

Për studentët e universiteteve të tjera, të të njëjtit program apo formë studimi, që duan të transferohen në këtë program studimi, propozimet vijnë nga Rektorati i Universitetit përcjellës, shoqëruar me të dhëna të hollësishme për studentin. Studenti që transferon programin e studimit duhet të ketë këto dokumente: a) kërkesën me shkrim për transferimin e programit të studimit; b) programi i studimit; c) kursi i studimit; d) forma e studimit; e) detyrimet e shlyera me notat përkatëse; f) fotokopje e kartës së identitetit; g) rregulloren mësimore të programit të studimit që transferon; h) nëse gëzon të drejtën e bursës apo jo. Vendimin për pranimin e studentëve, propozuar për transferim, e merr Rektorati, pasi ka marrë mendimin e Dekanit të Fakultetit përkatës.

4. KUSHTET DHE PROCEDURAT E MODALITETET PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE

Studentët mund të transferohen nga një universitet në tjetrin brenda të njëjtit program studimi në vitet e ndërmjetme. Komisioni vlerësues, që ngrihet në departament, vlerëson rast pas rasti dokumentacionin dhe formimin e studentit, për të përcaktuar nëse i duhet të shlyejë ndonjë lëndë, që ai nuk e ka zhvilluar në vitin e parë. Kërkesat për transferim duhet të

dorëzohen brenda datës 15 të muajit shtator në sekretarinë mësimore. Vlerësimi i dokumentacionit bëhet brenda datës 30 shtator dhe njoftimi një ditë më pas.

5. FORMAT E STUDIMIT, TË PROVIMEVE DHE VERIFIKIMEVE TË TJERA TË DIJEVE TË FITUARA NGA STUDENTËT

Forma e studimit është me kohë të plotë. Format e provimeve janë provime me shkrim dhe ose me gojë, sipas programit të çdo moduli. Gjithashtu, për të gjitha modulet parashikohet verifikim i vazhdueshëm i njohurive si dhe vlerësim i njohurive përgjatë semestrit. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit përfaqëson 30% të vlerësimit total. Përbërësit e vlerësimit të vazhduar bëhen nga çdo pedagog në programin e disiplinës a modulit dhe pasqyrohen në rregulloren e programit të studimit.

Vlerësimi përfundimtar në bazë të totalit të pikëve të provimit dhe vlerësimit të vazhduar do jetë:

deri në 39 pikë	Nota 4
40-50	Nota 5 (minimumi i pikeve 40)
51-60	Nota 6
61-70	Nota 7
71-80	Nota 8
81-90	Nota 9
Mbi 91	Nota 10 (maksimumi i pikeve 100)

6. DIPLOMA

Mbrojtja e Temës së Diplomës Bachelor bëhet publike dhe konsiston në një punim me shkrim për studentët me mesatare të ponderuar të të tre viteve të studimit mbi ose baraz me 7.5. Ky punim presupozohet të përbëjë rezultatin e një kërkimi pa kerkesa të theksuara origjinaliteti shkencor.

Për studentët e tjerë Mbrojtja e Temës së Diplomës Bachelor bëhet me provim me shkrim duke përfshirë pyetje nga të gjitha lëndët e formimit karakterizues të programit të studimit. Ky provim ju përmbahet të gjitha rregullave të provimit me shkrim dhe të vlerësimit të studentëve nga 0 në 100 pikë.

Teza e diplomës të nivelit të parë është një punim, në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera në fushat e programit përkatës të studimit. Teza e diplomës përmban kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave, në fushën përkatëse. Teza e diplomës është e lidhur me disiplina të përafërta dhe duhet të jetë individuale. Studenti që plotëson kriteret e përcaktuara nga kjo rregullore ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqësin e tij. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale.

Struktura e punimit:

Punimi duhet të shkruhet me shkrim Times New Roman, Font 12, Hapësira midis rreshtave 1,15.

1. Hyrje: përse kjo temë? (~2 faqe)
2. Çështjet themelore në fushën e brendisë. (~3 faqe)
4. Argumentet dhe analiza e të dhënave. (~20 faqe)
5. Përfundime, propozime, bibliografi. (~5 faqe)

Tipologjitë e temave:

Temat e hartuara nga studentet diplomante do të jene ne fushat e meposhtme te sistemeve te informacionit:

- *Internet Technologies*
- *Zhvillimi i aplikimeve në biznes (business application development)*
- *Zhvillimi i portaleve dhe aplikimeve ne Internet (Internet Application Development)*
- *Rrjetat dhe komunikimi (Communication and Networking)*
- *Aplikime të Database management systems (DBMS applications)*
- *Elemente te teorive dhe zbatime te gjuheve te programimit.*
- *Projektimi i amplifikatoreve me shume stade dhe amplifikatoret operacionale.*
- *Perpunimi i sinjaleve dhe teknika transmetimesh dixhitale.*
- *Sistemet moderne te telekomunikacionit.*

Tema e diplomës së Bachelorit zhvillohet nën drejtimin e një pedagogu si udhëheqës i temës. Gjithashtu, tema e diplomes ka dhe një pedagog oponent, i cili paraqet me shkrim vlerësimin e tij.

Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin brenda semestrit të parë të Vitit të tretë, të cilët firmosin një formular. Studenti, nëse e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë ndërrimin e udhëheqësit brenda afatit të përcaktuar më lart. Platforma me bibliografinë përkatëse dorëzohen përfundimisht pranë Sekretarisë se Departamentit.

Studenti nuk lejohet të mbrojë diplomën, nëqoftëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit të fundit si dhe ato të mbartura.

Për t'u pranuar në provimin e mbrojtjes së temës, studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit, të ketë marrë 173 kredite të Bachelorit. Punimi dorëzohet një muaj përpara datës së mbrojtjes në tre kopje. Studentët, të cilët nuk respektojnë këto afate ose/dhe nuk kanë marrë 173 kredite, nuk mund të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin e verës. Vetëm pasi të kenë shlyer detyrimet e mësipërme dhe të kenë dorëzuar, gjithashtu, punimin një muaj përpara datës së mbrojtjes, studentëve u buron e drejta të bëjnë mbrojtjen e temës në sesionin përkatës të vitit akademik pasardhës.

Studenti i vitit të fundit, i cili në përfundim të provimeve të kursit, në sezonin e parë, rezulton me detyrime mësimore të pashlyera, ka të drejtë t'i shlyejë ato në sezonin e verës, para mbrojtjes së diplomës.

Komisioni dhe vlerësimi

Komisioni përbëhet nga 3-5 pedagogë të fushave përkatëse. Komisioni caktohet nga Dekani i Fakultetit me propozim të Departamentit.

Për vlerësimin e temës mbahen parasysh tre kritere: përmbajtja e punimit, mënyra e paraqitjes me gojë dhe mesatarja e tre viteve të studimeve të programit Bachelor.

7. DETYRIMET QË LIDHEN ME FREKUENTIMIN

Studentët janë të detyruar të frekuentojnë 75% të seminareve. Në rast të mosrespektimit të këtij detyrimi, studenti shpallet përsëritës për atë lëndë.

8. DETYRIME PENGUESE

Programi i studimit i Bachelorit ka në total 180 kredite. Studenti, për të kaluar në vitin e dytë duhet të ketë shlyer minimalisht 20 kredite. Në rast të mosmarrjes së 20 krediteve nga 60 kredite që ka viti i parë nuk mund të kalojë në vitin e dytë. Ai shpallet përsëritës për vitin e parë. Për të kaluar në semestrin e pestë, studenti duhet të ketë përfituar minimumi 60 kredite.

Studenti, i cili nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit përpara mbrojtjes së Tezës së diplomës, nuk mund ta bëjë mbrojtjen. Vetëm pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet që parashikon programi, ai mund të bëjë mbrojtjen e tezës.

9. KALENDARI I PROGRAMIT MËSIMOR DHE I PROVIMEVE

Programi i studimeve “BACHELOR në Teknologji Informacioni” do të zhvillohet në 3 vite akademik, i ndarë në 6 semestra dhe përfundon me realizimin e 180 krediteve.

Viti akademik është i organizuar në javë mësimore, javë provimesh dhe përgatitje për mbrojtjen e temës së Diplomës.

Shlyerja e provimeve bëhet në 3 sesione: sesioni i dimrit (muajt janar-shkurt), sesioni i verës (muajt qershor-korrik), sesioni i vjeshtës (muaji shtator). Për mbrojtjen e tezës së diplomës janë max. 3 sesione.

Datat përcaktohen në çdo fillim të vitit akademik me vendim dekanati.

Programin e studimit “BACHELOR në Teknologji Informacioni” e ofron Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane i Universitetit “Fan S.Noli”.

10. PLANET MËSIMORE ME MODULET DHE KREDITET PËRKATËSE

Plani mësimor është paraqitur në pikën 7 të këtij dokumentacioni

11. OBJEKTIVAT FORMUESE SPECIFIKE PËR VEPRIMTARITË FORMUESE

Disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë), tipi A

Këto disiplina synojnë pajisjen e studentëve me dijet bazë në fushat në fushat në lidhje me matematikën dhe fizikën e përgjithshme.

Disiplina të formimit karakterizues, tipi B

Këto disiplina të formimit profesional synojnë ne pajisjen e studentit me kompetencat e duhura për t'iu përgjigjur kërkesave aktuale të zhvillimeve ne fushen e Teknologjisë te Informacionit. Ato e aftësojnë studentin në kryesisht aftesite programuese, analizen e sistemeve te bazave te te dhenave, teknologjite e internetit, rrjetat kompjuterike, bazat e elektronikës etj.

Disiplina të ngjashme ose integruese, tipi C

Disiplinat e ngjashme synojne ne një formim plotësues të studentit me dije nga fusha të ngjashme apo integruese edukim, ku mund të fusim elementë të kimisë së përgjithshme, nga fizika e përgjithshme elektricitetin, magnetizmin.

Disiplina formuese me zgjedhje nga studentët, tipi D

Disiplinat formuese të zgjedhura nga studentet.

Disiplina formuese të fushave ndihmese, praktikave profesionale etj, tipi E

Këto disiplina synojnë një formim më të veçantë të studentëve për disa fusha ndihmese, rritja e kompetencave ne menaxhin me synim rritjen e kompetencave në postin e specialistit të TIK. Ato e ushtrojnë atë në përballjen me individë apo grupe të natyrave të ndryshme dhe të veçanta.

Disiplina formuese për tezën e diplomës, tipi F

12. VEPRIMTARITË E ORIENTIMIT DHE TË KUJDESTARISË

Këto veprimtari synojnë këshillimin e studentëve, duke i ftuar ata që të marrin informacion të detajuar në fakultet dhe duke organizuar takime të drejtpërdrejta me to në mjediset e fakultetit.

Kujdestaria për studentët organizohet në rang fakulteti nga një grup pedagogësh, të cilët orientojnë vazhdimisht nxënësit përpara se të zgjedhin një program të caktuar studimi dhe përgjatë shkollimit.

13. KONTROLLE PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN PERIODIK TË KREDITEVE TË FITUARA NGA STUDENTËT QË KANË NDËRPRERË PËRKOHËSISHT STUDIMET PËR TË GARANTUAR MOSVJETËRIMIN E DIJEVE

Studentët, të cilët kanë ndërprerë studimet dhe janë larguar për një kohë të pacaktuar, mund të paraqesin një kërkesë për ripranim përpara përfundimit të vitit akademik në vijim. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni vlerësues, i cili përditëson njohuritë e kandidatëve me ndryshimet që mund të ketë pësuar programi i studimit.